

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7979
E mërkurë, 29 janar 2025
Çmimi 0.50 €

Fushatë midis urtësisë dhe urrejtjes

FAQE 6



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KQZ-ja AKREDITON VËZHgues TË DHJETËRA ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE, AMBASADAVE DHE OJQ-ve

FAQE 4



Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit duket se kanë zgjuar interesim të madh të përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Kosovë, vëzhguesve ndërkombëtarë të cilët

përfaqësojnë institucione zgjedhore nga shtete të ndryshme dhe organizatave ndërkombëtare. Vetëm gjatë mbledhjes mbajtur të martën, KQZ-ja ka akredituar vëzhguesit e dhjetëra përfaqësive të huaja

diplomatike të akredituara në Kosovë dhe të organizatave ndërkombëtare. Gjysma e parë e fushatës është përcjell me shumë aktivitete, por ka pasur gjuhë nxitëse dhe të urrejtjes nga partitë politike

VENDIMI I MINISTRIT VITIA PËR ÇMIMET E UNIFIKUARA TË BARNAVE PËRFUNDON NË GJYKATËN KOMERCIALE

F.7



RRITEN ÇMIMET E SHPORTËS

F.3



AKTUALE



ITALIA DËRAGON NË SHQIPËRI 49 EMIGRANTË

F.3

OPOZITA E BASHKUAR VAZHDON TA LË QYTETARIN E GJILANIT PA BUXHET

F.7

ÇFARË NDODHI NË SKENDERAJ?

F.5

EKONOMI



"COCA-COLA" URDHËRON TËRHEQJE MASIVE TË PIJEVE NË EVROPË

F.8

DREJTORI I ATK-së DHE AMBASADORI I LUKSEMBURGUT DISKUTOJNË PËR BIZNESET

F.8

SPORT



TREPÇA DHE PRISHTINA NË KËRKIM TË FINALES SË KUPËS

F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Protesta masive në Serbi, kryeministri jep dorëheqje

BEOGRAD, 28 JANAR - Kryeministri i Serbisë, Millosh Vuçević, dha dorëheqje nga pozita, mes valës së protestave për tragjedinë në Novi Sad. Duke folur në një konferencë të jashtëzakonshme për gazetarët në Beograd, ai tha se presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e ka pranuar vendimin e tij. "Unë besoj se politika që unë përfaqësoj, partia që unë drejtoj, duhet ta demonstrojë nivelin më të lartë të përgjegjësive dhe të futë norma të reja në politikën serbe, duke dëshmuar se është e përgjegjshme", tha Vuçević, njëherësh kryetar i Partisë Përparimtare Serbe në pushtet. Për më shumë se dy muaj në Serbi mijëra studentë dhe qytetarë të tjerë kërkojnë përgjegjësi penale dhe politike për tragjedinë në qytetin e Novi Sadit, ku më 1 nëntor të vitit të kaluar, 15 persona humbën jetën nga shembja e strehës në stacionin hekurudhor. Edhe pas vendimit të Vuçevićit për dorëheqje, përfaqësuesit e studentëve në Serbi thanë se kërkesat e tyre nuk janë plotësuar dhe

paralajmëruan protesta të reja. Vuçevići tha se do ta kryejë punën e tij si kryeministër, derisa të zgjidhet qeveria e re. "Kjo qeveri tani është në mandat teknik, në dorëheqje", tha ai dhe paralajmëroi, gjithashtu, dorëheqjen e kryetarit të Novi Sadit, Millan Gjuriq. Gjuriqi dha dorëheqje vetëm pak orë më pas. Presidenti i Serbisë, Vuçiq, tha një ditë më herët se të gjitha kërkesat e studentëve janë plotësuar. Gjatë atij fjalimi ai kërkoi edhe ristrukturimin e Qeverisë së Serbisë, në krye të së cilës Vuçevići ishte nga maji i vitit 2024. Përndryshe, më 30 dhjetor, Zyra e Prokurorit të Lartë Publik në Novi Sad ngriti aktakuzë kundër 13 personave në lidhje me shembjen e strehës së stacionit. Në mesin e të pandehurve janë: ish-ministri i Ndërtimit, Transportit dhe Infrastrukturës i Serbisë, Goran Vesiq, dhe ndihmësja e tij, Anita Dimoski, si dhe ish-drejtoresha e Ndërmarrjes Publike "Infrastruktura e Hekurudhave të Serbisë",



Jellena Tanasković. Dhjetë të pandehur janë në paraburgim, Vesiq është në arrati, ndërsa Tanasković dhe Dimoski janë në arrest shtëpiak. Prokuroria konfiskoi edhe dokumente nga institucione dhe kompani të shumta, si dhe urdhëroi një ekspertizë për ta përcaktuar shkakun e

shembjes së strehës së stacionit dhe përgjegjësit. Neni 132 i Kushtetutës së Serbisë thotë se kryeministri e paraqet dorëheqjen te kryetari i Kuvendit dhe e njofton njëkohësisht presidentin e Republikës dhe publikun për vendimin e tij. Kuvendi, në seancën e parë të radhës, konstaton dorëheqjen

e kryeministrit. Mandati i qeverisë përfundon në ditën e konfirmimit të dorëheqjes së kryeministrit. Pasi që Kuvendi ta konfirmojë dorëheqjen e kryeministrit, presidenti i Republikës është i detyruar ta fillojë procedurën për zgjedhjen e qeverisë së re. Nëse Kuvendi nuk arrin të zgjedhë qeverinë e re brenda 30 ditëve nga data e dorëheqjes së kryeministrit, presidenti i Republikës është i detyruar ta shpërndajë Kuvendin dhe t'i shpallë zgjedhjet e reja. Kërkesat e studentëve për ndalimin e bllokadave përfshijnë publikimin e dokumentacionit të plotë për rindërtimin e Stacionit Hekurudhor të Novi Sadit, për ta përcaktuar përgjegjësinë për aksidentin e 1 nëntorit 2024. Ata, gjithashtu, kërkojnë që sulmuesit e demonstruesve nëpër Serbi, gjatë protestave që pasuan aksidentin, të identifikohen dhe të përballen me përgjegjësi penale. Kërkesat përfshijnë edhe lirimin e aktivistëve të arrestuar gjatë protestave, ndalimin e procedurave penale kundër tyre, si dhe rritjen e buxhetit për universitetet.

Trumpi nënshkruan urdhër ekzekutiv për rishikimin e politikës për ushtarët transgjinjorë

WASHINGTON, 28 JANAR - Presidenti amerikan Donald Trump ka nënshkruar një urdhër ekzekutiv që udhëzon sekretarin e Mbrojtjes, Pete Hegseth, që ta rishikojë politikën e Pentagonit për trupat transgjinjorë, vendim që me gjasë mund të çojë drejt një ndalimi të shërbimit të tyre ushtarak në të ardhmen. Ai, po ashtu, urdhëroi që trupat, që ishin larguar vullnetarisht apo ishin larguar nga puna për shkak se kishin refuzuar ta merrnin vaksinën për Covid-19, të kthehen në ushtri. Në urdhrin e tij për transgjinjorët, Trumpi tha se shërbimi nga trupat që identifikohen me gjini të ndryshme nga gjinia e tyre biologjike, "bie ndesh me



angazhimin e një ushtari për një mënyrë jetese të ndershme, të vërtetë, të disiplinuar, madje edhe në jetën personale" dhe e dëmton gatishmërinë ushtarake, duke kërkuar një politikë të rishikuar për ta adresuar këtë çështje. Edhe gjatë mandatit të parë si president, Trumpi kishte tentuar t'ua ndalonte transgjinjorëve që të shërbenin në ushtri, por çështja u zvarrit nëpër gjykata dhe më pas u hodh poshtë nga pasardhësi i tij, Joe Biden, pak kohë pasi mori detyrën. Dy grupet, Lambda Legal dhe Human Rights Campaign, që përfaqësonin ushtarët transgjinjorë kur Trumpi shërbeu për herë të parë si president, janë zotuar se do të

luftojnë sërish kundër urdhrin të ri të presidentit. "Kemi qenë në këtë situatë edhe shtatë vjet më parë dhe kemi arritur në mënyrë të suksesshme t'i bllokoni përpjekjet e administratës", tha avokati i Lambda Legal, Sasha Burchet, duke argumentuar se një vendim i tillë cenon sigurinë e trupave dhe shtetit, duke u zotuar se grupet për të drejtat e transgjinjorëve sërish do ta dërgojnë çështjen në gjykata. Afër 1.3 milion është numri i personelit aktiv që shërben në ushtrinë amerikane, sipas të dhënave të Departamentit të Mbrojtjes. Përdërisa grupet për të drejtat e transgjinjorëve thonë se deri në 15 000 ushtarë transgjinjorë janë në ushtri, zyrtarët thonë se numri i tyre është më i vogël.

Senati konfirmon Sekretarin e Thesarit, Scott Bessent

Washington, 28 janar - Senati amerikan konfirmoi të hënën Scott Bessentin sekretar i Thesarit në qeverinë e presidentit Donald Trump, duke i dhënë kështu drejtuesit miliarder të fondeve të investimeve, një rol qendror në hartimin e përparësive politike të administratës së re

në lidhje me uljen e taksave, të shpenzimeve qeveritare dhe menaxhimin e marrëdhënieve ekonomike me aleatët dhe kundërshtarët. Sekretari i 79 i Thesarit, Bessent, do të ketë ndikim mbi mbledhjen e taksave dhe tregun e borxhit të thesarit prej 28 trilionë dollarësh, mbi

politikën fiskale, rregulloret financiare, sanksionet ndërkombëtare dhe investimet nga jashtë. Votimi ishte 68-29, me 16 demokratë që mbështetën emërimin e tij. Bessent, 62 vjeç, tashmë është shfaqur si mbrojtës i fuqishëm për agjendën ekonomike të

presidentit Trump, e cila përqendrohet tek ulja e taksave dhe vendosja e tarifave të larta, që demokratët dhe disa ekonomistë, argumentojnë se mund të zhbëjnë një pjesë të përparimit që ka bërë Rezerva Federale në vendosjen e inflacionit nën kontroll.



Italia dërgon në Shqipëri 49 emigrantë

TIRANË, 28 JANAR - Një anije e marinës italiane ka arritur më 28 janar në Shqipëri me 49 emigrantë në bord, të cilët u shpëtuan në ujërat ndërkombëtare. Në Shqipëri atyre do t'u procedohen aplikimet për azil dhe më pas do të dërgohen në Qendrën e Strehimit në Gjadër. Kjo është përpjekja e tretë për strehimin e emigrantëve në Shqipëri, pasi paraprakisht gjykatat italiane e kishin ndaluar një gjë të tillë. Ministria e Brendshme italiane nuk ka specifikuar nacionalitetin e emigrantëve që u dërguan në portin e Shëngjinit, por mediet në Itali kanë raportuar se bëhet fjalë për persona nga Bangladeshi, Egjipti, Bregu i Fildishtë dhe Gambia.

Përpjekja për procesimin në Shqipëri pasoi dy përpjekje të dështuara tetorin dhe nëntorin e kaluar, kur gjykatësit italianë refuzuan të miratonin urdhra për ndalimin e dy grupeve të vogla emigrantësh në qendrat e ngritura në Shqipëri sipas një marrëveshjeje në mes të Italisë dhe Shqipërisë. Gjykatat vendosën se vendet e origjinës së emigrantëve nuk ishin të sigurta për ta, nëse aplikimet

për azil do t'u refuzoheshin dhe emigrantët do të ktheheshin në shtetet e tyre.

Rastet janë dërguar në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, e cila më herët ka vendosur se azilkërkuessit nuk mund t'u nënshtrohen procedurave të përsheptuara që mund të çojnë në riatdhësim nëse shtetet e tyre të origjinës nuk vlerësohet se janë plotësisht të sigurta. Seanca dëgjimore për këtë rast në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë është caktuar të mbahet më 25 shkurt.

Qeveria e kryeministres italiane, Giorgia Meloni, është zotuar se do t'i rihapë dy qendrat për emigrantë në Shqipëri, pasi ato mbeten bosh pas vendimeve të gjykatave italiane.

Qëndrimi i Melonit është mbështetur pjesërisht nga një vendim i Gjykatës së Lartë të Italisë në dhjetor, në të cilin gjykatësit italianë thanë se nuk mund t'i zëvendësojnë politikën e qeverisë sa i përket vendimit se cilat shtete janë të sigurta për riatdhësimin e emigrantëve që u është refuzuar kërkesa për azil.

Ky vendim lejon që gjykatat e niveleve më të ulëta të bëjnë



përcaktime të tilla në bazë të shqyrtimeve të rasteve individuale, pa vendosur për politikën e përgjithshme.

Emigrantët pritet të regjistrohen në qendrën e pritjes në portin e Shëngjinit dhe më pas të dërgohen në Qendrën e Strehimit në Gjadër. Marrëveshja ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë për emigrantët, e arritur në nëntor të vitit 2023, lejon që deri në 3 000 emigrantë të kapur nga rojet bregdetare

italiane në ujërat ndërkombëtare çdo muaj të strehohen në Shqipëri, ku do t'i nënshtrohen procesit të verifikimit për marrjen e mundshme të azilit në Itali.

Marrëveshja pesëvjeçare është thënë se do t'i kushtojë Italisë 160 milionë euro në vit.

Sipas marrëveshjes, procedurat për emigrantët do të kryhen në dy qendra.

Qendra e parë në Shëngjin do të

përdoret për procedura të identifikimit të emigrantëve, ndërsa qendra e dytë, në Gjadër, rreth 20 kilometra larg portit, do të shërbejë për strehim të tyre derisa të procesohen kërkesat për azil.

Qendrat do të funksionojnë sipas ligjit italian, me staf italian të sigurisë, ndërsa gjyqtarët do t'i mbajnë seancat përmes video-lidhjes nga Roma.

Emigrantët që fitojnë azil do të mirëprehen në Itali, ndërsa atyre që iu refuzohet kërkesa për azil, sipas marrëveshjes, do të riatdhësohen drejtpërdrejt nga Shqipëria.

Aktivistët për të drejtat e njeriut e kanë kritikuar marrëveshjen, duke thënë se krijon një precedent të rrezikshëm.

Deri më tani gjatë këtij viti, 3 704 emigrantë kanë arritur në Itali, apo dyfish më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kur ishin 1 305 imigrantë.

Vitin e kaluar 66 317 imigrantë arritën në Itali, apo 58 për qind më pak se viti paraprak.

Shumica e emigrantëve ishin nga Bangladeshi, Siria, Tunizia dhe Egjipti, sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme italiane.

Aktakuzë kundër një serbi që dyshohet për dhunë seksuale gjatë luftës në Kosovë

PRISHTINË, 28 JANAR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur të martën aktakuzë kundër të pandehurit me inicialet C. K., i nacionalitetit serb, për kryerje të veprës penale: krim i luftës kundër popullsisë civile.

Përmes një komunikate për medie, Prokuroria ka thënë se hetimet kanë vërtetuar se i pandehuri ka kryer dhunë seksuale ndaj një viktime të nacionalitetit shqiptar në periudhën e luftës në Kosovë më 1998-1999.

Prokuroria i ka propozuar Gjykatës Themelore në Prishtinë që procesi gjyqësor të zhvillohet në mungesë, pasi i pandehuri është i paarrtshëm për organet e



drejtësisë.

Prokuroria Speciale ka ngritur një varg aktakuzash të tjera në mungesë edhe në fund të dhjetorit, kryesisht për krime të kryera gjatë luftës në

Kosovë.

Gjykimi në mungesë, sipas sistemit të drejtësisë në Kosovë, mund të zhvillohet vetëm me kusht që prokuroria dhe gjykata t'i kenë shteruar të gjitha mjetet

për ta siguruar praninë e të akuzuarit.

Ehat Miftaraj nga Instituti i Drejtësisë në Kosovë i ka thënë Radios Evropa e Lirë javë më parë se institucionet e Kosovës, me shumë gjasë, bazuar në ligjet në fuqi, do të lëshojnë fletarrestime të kuqe të Organizatës Ndërkombëtare të Policisë (Interpolit) për personat që janë dënuar në mungesë për krime lufte.

Më 26 dhjetor të vitit që lamë pas, Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar me 15 vjet burgim Çedomir Aksiqin për akuzën krime lufte kundër popullsisë civile, të kryera nga janari deri në maj të vitit 1999 në territorin e komunës së Shtimes,

përkatësisht në fshatrat Reçak, Malopolc dhe Petrovë.

Ky është vendimi i parë për krime lufte i marrë në mungesë bazuar në Kodin e ndryshuar të Procedurës Penale të vitit 2022.

Radio Evropa e Lirë i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë në Qeverinë e Kosovës me pyetjen nëse është kërkuar lëshimi i ndonjë fletarrestimi të kuq për Aksiqin para gjyqimit, dhe nëse do ta bëjë tani pas vendimit, por nuk ka marrë përgjigje.

Kosova nuk është anëtare e Interpolit, prandaj fletarrestimet lëshohen me ndërmjetësimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Molliqaj viziton OVLUÇK-në: Qeveria Kurti ka qenë më e rrezikshmja për veteranët e luftës

PRISHTINË, 28 JANAR - Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, ka vizituar Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Ai ka bërë me dije se bashkëpunimi me organizatat e dala nga lufta është i domosdoshëm.

Molliqaj ka shkruar në "Facebook" se qeverisja e tanishme ka qenë më e dëmshme dhe më e rrezikshmja për veteranët e UÇK-së. "Bashkë me aktivistë të PSD-së vizituam OVL-në për t'i përgëzuar për

mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe për ta uruar punën e kryesisë së re dhe kryetarin e zgjedhur nga ky proces, z. Hysni Gucati. Bashkëpunimi me organizatat e dala nga lufta është i domosdoshëm. Qeverisja e tanishme ka qenë më e dëmshme dhe më e rrezikshmja për veteranët e UÇK-së. Mbi të gjitha, kundërshtimi i Gjykatës Speciale po bëhet çdoherë e më jetik", ka shkruar Molliqaj, duke shtuar se kjo kategori e

njerëzve nuk mund të hedhet si mbetje e historisë. "Veteranët e UÇK-së nuk guxojmë t'i lejojmë që të shndërrohen në variable kalkuluese me kosto e fitim. As s'mund t'i hedhim tutje si mbetje e historisë. Njëjtë si roli i tyre në luftën çliruese, që është i paprekshëm e i patjetërsueshëm, po njëjtë është roli i tyre edhe sot. Është përgjegjësi e secilit prej nesh që këtë rol historik e bashkëkohor ta ruajmë me çdo kusht", ka shkruar Molliqaj.





KQZ-ja akrediton vëzhgues të dhjetëra organizatave ndërkombëtare, ambasadave dhe OJQ-ve

Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit duket se kanë zgjuar interesim të madh të përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Kosovë, vëzhguesve ndërkombëtarë të cilët përfaqësojnë institucione zgjedhore nga shtete të ndryshme dhe organizatave ndërkombëtare. Vetëm gjatë mbledhjes mbajtur të martën, KQZ-ja ka akredituar vëzhguesit e dhjetëra përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Kosovë dhe të organizatave ndërkombëtare. Gjysma e parë e fushatës është përcjell me shumë aktivitete, por ka pasur gjuhë nxitëse dhe të urrejtjes nga partitë politike

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 28 JANAR - Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit duket se kanë zgjuar interesim të madh të përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Kosovë, të vëzhguesve ndërkombëtarë të cilët përfaqësojnë institucione zgjedhore nga shtete të ndryshme dhe të organizatave ndërkombëtare. Vetëm gjatë mbledhjes mbajtur të martën, KQZ-ja ka akredituar vëzhguesit e dhjetëra përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Kosovë dhe të organizatave ndërkombëtare.

Në mesin e të akredituarave ishin edhe organizata joqeveritare vendore dhe vëzhgues nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Në përgjithësi, KQZ-ja akreditoi grupin e radhës prej 1 680

vëzhguesve për vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025, prej të cilëve 13 vëzhgues nga trupa të menaxhimit të zgjedhjeve nga shtete të ndryshme; 81 vëzhgues të përfaqësive të vendeve të huaja të akredituara në Kosovë; 1 126 vëzhgues nga OJQ-të vendore; 393 vëzhgues nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe 67 vëzhgues nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Nga numri i përgjithshëm i të akredituarve, KQZ-ja akreditoi rreth 400 vëzhgues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare të cilat janë të specializuara në fushën e zgjedhjeve, në mesin e të cilave: Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Asociacioni i Zyrtarëve Zgjedhorë Botërorë

(A-ËEB), IFES, International IDEA, National Democratic Institute (NDI), International Republican Institute (IRI), Zyra e BE-së në Kosovë, etj. Po ashtu, KQZ-ja akreditoi më shumë se 80 vëzhgues të ambasadave të ndryshme në Kosovë, 24 prej të cilëve nga ambasada e ShBA-së dhe 30 të tjerë nga ajo e Britanisë së Madhe.

Edhe ambasadat e shteteve të tjera si ajo e Francës, Italisë, Holandës, Japonisë, Finlandës, Suedisë dhe Turqisë u akredituan nga KQZ-ja. Sipas njoftimit të KQZ-së, zgjedhjet e 9 shkurtit do të vëzhgohen edhe nga institucione zgjedhore nga shtete të ndryshme, si Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut e Bullgaria. Koalicioni i OJQ-ve Demokracia në Veprim (DnV) ka njoftuar një ditë më parë lidhur me mbarëvajtjen e dy

javëve të fushatës zgjedhore, mbulimin medial, gjuhën e urrejtjes dhe shpenzimet në rrjetet sociale. Sipas DnV-së, subjektet politike kanë vazhduar me intensitet të shtuar të aktiviteteve, në një ambient kryesisht të qetë, ndonëse shqetësues mbetet vazhdimi i përdorimit të gjuhës nxitëse dhe të urrejtjes në aktivitetet e mbajtura nga subjektet politike.

Në tërësi gjatë dy javëve të para, DnV ka monitoruar 377 tubime publike (160 në javën e parë, ndërsa 217 aktivitete të tjera në javën e dytë) të subjekteve politike, në të gjitha komunat e vendit, duke përfshirë edhe ato me shumicë serbe.

Me numrin më të madh të aktiviteteve po vazhdon të prijë LDK-ja me 109 aktivitete, ndjekur nga PDK-ja me 106 aktivitete, LV-ja me 71 aktivitete, si dhe AAK-ja me 54 aktivitete. Aktivitete kanë mbajtur edhe subjektet e tjera si Lista për Familjen, si dhe subjektet e komuniteteve të tjera, si Lista Serbe, Za Slobodu Pravdu i Opstanak, Srpska Demokratija, IRDK, PRBK etj. Subjektet politike i kanë koncentruar tubimet e tyre publike nëpër qendrat kryesore, përfshirë Prizrenin (45 aktivitete), Prishtinën (27

aktivitete), Pejën (23 aktivitete) dhe Gjilanin (22 aktivitete). Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Ardian Hajdaraj, ka pritur të martën në takim Koordinatorin Nacional për Zgjedhje nga radhët e sistemit prokurorial, prokuroren në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Laura Pula.

Fillimisht kryesuesi Hajdaraj përgëzoi koordinatoren Pula dhe stafin e saj për gatishmërinë e treguar dhe angazhimin konsekuent përgjatë viteve të kaluara në mbrojtje të votës së qytetarëve dhe, njëkohësisht, i shprehu mbështetjen dhe përkrahjen në këtë proces të zgjedhjeve nacionale në vendin tonë. "Zonja Pula keni mbështetjen tonë të plotë për trajtimin e secilit rast dhe i bashkohem ftesës dhe apelit tuaj që qytetarët t'i raportojnë rastet te Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës, të cilët mund të kenë informata për cenimin e fshehtësisë së votës apo për çfarëdo veprimi tjetër i cili përbën vepër penale kundër të drejtës së votimit", tha Hajdaraj. Gjithashtu, Pula e njoftoi kryesuesin Hajdaraj për planin operativ të institucionit të Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e votës së lirë të

Çfarë ndodhi në Skenderaj?

PRISHTINË, 28 JANAR - Lëvizja Vetëvendosje, parti në pushtet, është pritur me protestë të hënën në komunën e Skenderajt, në një vizitë në kuadër të fushatës për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Disa qytetarë kanë protestuar para vendit ku ishte planifikuar të fliste Albin Kurti, kryeministër i Kosovës, i cili synon edhe një mandat në këtë pozitë, si dhe janë dëgjuar duke bërtitur "Thaçi, Thaçi", referencë për ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçin, dhe ish-kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), që tradicionalisht ka qenë në krye të garës në këtë komunë. Në zgjedhjet e vitit 2021 PDK-ja pati siguruar 70.9 për qind të

votave në këtë komunë, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje 20 për qind. Sipas pamjeve të publikuara në rrjetet sociale, Policia e Kosovës është detyruar të ndërvejojë në aksionin e protestuesve, të cilët kanë përdorur edhe mjete piroteknike. Zyrtarë të Policisë së Kosovës i kanë thënë Radios Evropa e Lirë se aktualisht nuk ka të arrestuar për këtë incident. Përmes faqes zyrtare në "Facebook", Lëvizja Vetëvendosje ka thënë se ka dështuar "përpjekja për ta pamundësuar tubimin në qytetin e Skenderajt". "Vazhdojmë cep më cep vendit", është thënë në postim. Vetë Kurti ka thënë në

"Facebook" se bastioni i partisë që udhëheq është "zemra e qytetarit të Republikës". "Drenica është zemra e Kosovës. Rroftë familja Jashari! Rroftë Skenderaj! Rroftë kombi shqiptar!", ka thënë ai. Ministri i Kulturës, Hajrullah Çeku, e ka dënuar këtë pritje në Skenderaj, ndërsa protestuesit i ka përshkruar si "qyqarë". "Harroni që na ndalni. Po thyejmë bastione një nga një, cep më cep. Dje në Deçan, sot në Drenicë, e çdo ditë deri në 500 mijë zemrat e 9 shkurtit", ka thënë ai në rrjetin social "Facebook". Anëtarë të shoqërisë civile e kanë kritikuar Çekun për gjuhën e përdorur. Rrjeti i organizatave joqeveritare, Demokracia në

Veprim (DnV), shprehi shqetësimin për incidentin e ndodhur në Skenderaj, duke dënuar "çdo formë dhune, provokimi apo ndërhyrje në proceset demokratike, veçanërisht gjatë një periudhe kaq të ndjeshme të fushatës zgjedhore". "Të tilla akte janë një sulm ndaj lirisë së grumbullimit dhe shprehjes së lirë, duke krijuar një atmosferë tensioni dhe pasigurie që bie në kundërshtim të plotë me parimet themelore të demokracisë". DnV ka thënë ditë më parë se subjektet politike e kanë rritur përdorimin e gjuhës nxitëse apo të urrejtjes në javën e dytë të fushatës zgjedhore. Në një konferencë për medie, Violeta Haxholli nga kjo

organizatë ka thënë se 20 për qind e fushatës, e cila ka nisur më 11 janar, ka përmbytur gjuhë të tillë deri tani. Sipas DnV-së, Lëvizja Vetëvendosje ka përdorur gjuhë nxitëse apo të urrejtjes në 25 për qind të aktiviteteve të saj zgjedhore, Lidhja Demokratike e Kosovës në 20 për qind, Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma në 18 për qind, dhe Partia Demokratike e Kosovës në 11 për qind. Për këto zgjedhje janë certifikuar 28 subjekte politike me 1 280 kandidatë. Zgjedhjet e 9 shkurtit do të jenë zgjedhjet e para të rregullta parlamentare që do të organizohen në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë më 2008.



qytetarëve të Republikës së Kosovës në zgjedhjet nacionale, të cilat mbahen më 9 shkurt 2025. Kryesuesi Hajdaraj dhe koordinatorja Pula janë pajtuar në këtë takim që të gjitha aktivitetet të kenë në vëmendje moscenimin e procesit aktual zgjedhor dhe mbarëvajtjen e rregullt deri në përmbylljen e tij, përfshirë këtu edhe bashkëpunimin e afërt me institucionet e tjera ligjzbatuese dhe atyre që merren me administrimin e zgjedhjeve dhe shqyrtimin e rasteve zgjedhore. Edhe Policia e Kosovës, bazuar

në ligjet pozitive të vendit dhe autorizimeve si agjenci kyçe për sigurinë publike në tërë territorin e vendit, ka hartuar urdhrin operativ policor me kohë dhe ka bërë të gjitha planifikimet policore lidhur me "Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës". Me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor është paraparë të angazhohet një numër i mjaftueshëm i zyrtarëve policorë, kryesisht të rendit publik por, sipas nevojës, mund të angazhohen edhe zyrtarë policorë të profileve të ndryshme, që iu përkasin

njësiteve të ndryshme brenda Policisë së Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) para disa ditësh ka njoftuar se ka filluar shtypja e fletëvotimeve për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të cilat do të mbahen më 9 shkurt. Shtypja e fletëvotimeve po realizohet në shtypshkronjën e dokumenteve me siguri të lartë, "Cetis", në Celje të Sllovenisë. Sipas vendimit të KQZ-së, do të shtypen 1 752 fletëvotime. Ky proces po zhvillohet sipas standardeve ndërkombëtare dhe është nën mbikëqyrjen e një delegacioni të KQZ-së të

udhëhequr nga kryesuesi Kreshnik Radoniqi dhe stafi i Sekretariatit të KQZ-së. Në nëntë palë zgjedhjet e mbajtura në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë më 2008, kanë votuar më pak se 50 për qind e gjithsej votuesve të regjistruar. Por, jo të gjitha grupet - komunitetet etnike, gjinitë e grupmoshat - janë paraqitur në vendvotime në të njëjtën përqindje. Të dhënat e ndara për gjini tregojnë se burrat votojnë në përqindje më të lartë se gratë. Në të gjitha zgjedhjet, përveç zgjedhjeve lokale të vitit 2013, burrat në Kosovë kanë votuar

në përqindje më të lartë sesa gratë. Në zgjedhjet e fundit parlamentare ky hendek është rritur në krahasim me zgjedhjet paraprake. Ndërkohë, janë të rinjtë ata që në ditën e zgjedhjeve drejtohen të vendvotimet në përqindjen më të lartë. Mbi 53 për qind e të rinjve që për herë të parë kishin mundësinë e votimit, e shfrytëzuan atë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Asnjë grupmoshë tjetër nuk kishte përqindje më të lartë të votimit, ndërsa në vendin e dytë ishte grupmosha nga 41 në 44 vjeç, me gati 49 për qind.

Fushatë midis urtësisë dhe urrejtjes



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Shvarc në zemër, Shvarc me gojë: Fushata deri më tani kryesisht ishte e urtë, jotensionuese dhe qytetare, përjashtuar përshkallëzimin e stisur të partisë multietnike VV-së që bëhet për ta larguar vëmendjen nga impotencia e qeverisjes sikur edhe për të fituar vota. Fushata e VV-së nënkupton ekskluzivisht fushatën e Albin Kurtit, edhe kur flasin ameba politike apo kryetari i Kuvendit sikur edhe mendermethënë ministria për MPJD-së, Donika Schwarz. Ky farë peci i Albinit po lufton në ligjet e anatomisë duke bërë përpjekje që ta rrisë mbiemrin në diçka më të madhe përmes fyerjeve dhe korrupsionit përmes subvencioneve. Haxhi Qamili pak po dëgjohet. Kjo është anëtarësia e Guxo, e shkrirë në VV. Nëse këta tre sistemohen, konsiderohet se janë përmbushur synimet e Guxo. Dikur Perandoria Otomane, njësitë më të guximshme dhe më të pamëshirshme i formonte nga fëmijët që i merrte peng në vendet e pushtuara të cilët i ushtronte të kryen krimet më të tmerrshme pikërisht kundër popujve të cilit i takonin. Këta ishin jeniçerët e njohur për mizori dhe monstruoze. Jeniçerët e LDK-së, tash në radhët e ushtrisë vrastare virtuale të VV-së multietnike, Donika Schwarz, peci i Albinit dhe Haxhi Qamili, luftën më të madhe e bëjnë kundër LDK-së në përpjekje për ta dëshmuar rolin e rrogëtarit ndaj zotëriut të tyre dhe pronarit real, Padishahut Albin Kurtit të Dytë për ta bërë Albin Kurti i Tretë. Haxhi Qamili nuk ka kapacitet as për pordhë lokale e lëre më të ushtrisë ndikim nga "hamami i Hyrës" nga dolën Guxo dhe Alternativa e Zdravo Mimosës. Trojka e Guxo, bashkë me kuislingen Vojsa Osmani e masakruan LDK-në duke e përgjysmuar dhe shndërruar në pre të lehtë për kanibalët parapolitik të VV-së. Në rrethana normale asnjë votues i vërtetë i LDK-së, në asnjë rrethanë nuk do ta votonte VV-në dhe rroshkopellon Kurti. Në rrethana të ikjes së trurit për një bythë karrige, atë çka e bënë kuislingja Osmani, me mercenarët Schwarz, peci i Albinit dhe Haxhi Qamili shitet si vlerë e shtuar e demokracisë - tradhtisë e që do iu kthehet shumë shpejt. Vojsa Osmani, si

dhunuese e rugovizmit, po përpiqet të bëhet rugoviste duke e rregulluar xhipin e Rugovës e që e ka vendosur në shesh të kryeqytetit, përballë Kuvendit të Kosovës. Simulon përcaktimin rugovist, me para të qytetarëve të Kosovës që me njëqindmijë probleme i paguajnë faturat e rrymës së nënshkruar nga knjazi i kontrabandistit me rrymë, "Bacës Martin - GEN-it, dhe ndërmarrjes së përbashkët të strukturuar kriminale të quajtur KOSTT-i që, përveç rrymës, ua mërduhu qytetarëve me fatura kriminale të nxemjes. Një katastrofë elementare njerëzore dhe kombëtare, urrejtëse patologjike e Bacë Adem Demaçit, ish të burgosurve politikë, UÇK-së, luftëtarëve të lirisë dhe patriotëve të vërtetë përveç se pati deklaruar se kishte dërguar dosje në Hagë kundër luftëtarëve të lirisë, u lavdërua nga Ivica Daçiq në Këshill të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për kontribut të saj kundër kriminelëve të UÇK-së në përgjithësi dhe kundër Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, në veçanti. Për luftëtarin e orëve të para të UÇK-së që bëri një luftë të papërsëritshme dhe heroike, me tërë familjen, Ramush Haradinaj, me dy vëllezër heronj të kombit, Luanin dhe Shkëlzenin, urrejtja patologjike kundër shqiptarëve patriotë, Donika Schwarz, nuk pati kurrë asnjë cilësim përveç se është kriminel dhe se të tillë janë edhe luftëtarët e tjerë të lirisë. Me urrejtjen dhe imagjinatën e shëmtuar ia kalon edhe Danica Marinkoviqit dhe Hajrie Spikericës. E paskrupullt, pa asnjë mëdyshje! MPJD e ka shndërruar në vend ku me ligj mbrohet prostitucioni diplomatik. Edhe nga vet KM Kurti. Kjo është turpi i Kosovës, deri më 9 shkurt 2025. Pa asnjë rezultat pozitiv, as brenda e as jashtë vendit. A ka diçka më të turpshme se kur kjo karikaturë politike përqesh 30 vitet e burgut të Bacë Adem Demaçit, luftën titanike dhe plagët e Ramush Haradinajt, gjakun e derdhur për liri të Luan dhe Shkëlzen Haradinajt, shekuj e shekuj burje politike si dhe luftën e lavdishme të së Lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovë, me Komandantin Legjendar, Adem Jashari. Kjo, që moti e ka dëshmuar se përveç se është Schwarz (katran) në zemër, e tillë është edhe në të vjella kundër çdo vlere njerëzore dhe kombëtare. Fushata ka hyrë në dy javët e fundit ne ç'rast nga Albin Kurti dhe vartësit pa kurriz, dinjitet dhe integritet po shpërndahet urrejtja jonormale kundër çdo gjëje normale që ndërlihet me

shtetin, institucionet, ligjet, Kushtetutën, mediat, organizatat joqeveritare, sikur të ishim në Bellorusi e jo në Kosovë dhe Shqipëri. Është krijuar një mjedis toksik dhe qytetarët po dhunohen pamëshirshëm nga "çkapës" të shtetit e që nuk lanë gjë pa kapur, në emër të çkapjes së premtuar. Mediat i sulmon se ia bëjnë publike hajninë dhe impotencën qeverisëse. Prokurorinë dhe gjykatat i sulmon sepse ua kanë hapur rrugën drejt Dubravës dhe Dyzit. Po e sulmojnë opozitën që të mos bëhet pozitë. Po i sulmojnë patriotët e vërtetë në emër të patriotizmit jugosllav. Kanë mungesë të ADN-së kombëtare, janë pa histori dhe pa kontribut për çlirimin dhe lirinë e vendit. Nuk janë veteranë të UÇK-së por vazhdimësi biologjike dhe politike e nostalgjisë jugosllave dhe serbe. Shpirti rugovist është brenda Guxo për aq sa është shpirti patriotik në pjesën dërrmuese të partisë multietnike VV-së që edhe ëndrrat i shohin si në kohën e Titos. Pak ka patriotë sot në VV - ë por ka shumë keqpërdorues të flamurit kombëtar dhe bashkimit kombëtar. Paturpësisht duan të bashkëdyzojnë Hasan Prishtinën me Oliver Ivanoviqin, për qëllime politike. Albin Kurti i do 500.000 vota apo 500 K ndërsa ka mundësi të fitojë maksimumin 250 K (peca). Pastaj, lojën që po e luan duke imponuar "rregullat e Gotit", do t'i kthehet si bumerang, nuk është më lojtari, as i vetëm e as kryesori. Zhvillimet ndërkombëtare do të jenë vendimtare për arkitekturën politike dhe shtetërore të Kosovës. Denoncimi i ulët i hermafroditit politik, ndryshe ish-kryetar i Kuvendit dhe kacavjerrja pas Grenellit ishte ballon provues i vet Kurtit përmes lakeut të tij e që u rrëzua nga vet Grenell. Çfarë kohe dhe kush do të besonte se Grenell do të refuzojë vardisjen pornografike të VV-së! Janë këto shenjat e para të kijametit....për VV-në dhe pakurrizorët përfaqësues. Jam i sigurt se Albin Kurti nuk do të jetë në gjendje të pengojë asnjë proces në të ardhmen, edhe nëse llogaritë që pas një viti, kur të shkartiratet Vojsa si presidente, do të provokojë zgjedhje të reja ku do të fitonte si Llukashenko mbi 86 për qind të votave. Asgjë nuk do të ketë prej kësaj pune. LDK-ja po bënë fushatë amerikane nga ambalazhimi sepse ka futur shumë para në fushatë. Kam përshtypjen se materialisht kanë investuar sa të gjitha partitë tjera bashkë. PDK-ja po bënë fushatë racionale, pa urrejtje dhe hakmarje. Edhe kur brutalisht po sulmohet. PDK-së po ia fusin vezët e qyqes

duke e akuzuar se ka marrëveshje të fshehtë me partinë multietnike VV-në për koalicion pas zgjedhjeve, me Bedrushin kryeministër dhe Albushin president. Lajme të Hajrie Spikericës dhe Mimoza Zemplakices. AAK-ja po bënë fushatë tradicionale, duket se po forcohet mirë kurse Nisma ka "veç Vepra". Hajgarexinjë të mëdhenj janë Nisma (ë)tarët. Koalicioni për Familjen po e bënë fushatën sipas organizimit të treshes, sikur të kishin dalë nga LPK-ja. Ndoshta ngjallen pak...tri ditë para Bajramit (zgjedhjeve).

Rezultatet e projektuara: Partitë shqiptare që do të jenë pjesë e Kuvendit të Kosovës, lehtësisht mund t'i marrin mbi 60 deputetë. Partia multietnike VV do të luajë për shifrën e 41 deputetëve për ta kallur lojën në të ardhmen. Problem do ta ketë. Shumë problem. Formimi i qeverisë do të ngjajë me Darkën e Fundit ku Jezusi iu drejtohet apostujve në fjalët se: "dikush nga ju do të më tradhtojë...". Ashtu edhe ndodhi, Jezusi nuk e pati fundin e mirë.

LDK-ja po bënë fushatë intensive, Miri i Gjiksë ka fuqi fizike të një gladiatori por edhe truri po i punon mirë. Edhe Bedri Hamza ka kondicion të lakmueshëm, fizik dhe mendor. Me rastin e vdekjes se Janullatosit, sipas disa burimeve thuhet se me propozimin e Dejana Mihalit janë shpallur tre ditë zie. Kurti iku në Davos kurse Schwarz, u azilua në një strehimore azili në Washington, në hotelin "Waldorf Astoria", vend i specializuar për të pastrehët, me një pagesë modeste prej 3500 dollarë nata Kështu veprojnë ata që e marrin pushtetin, për ta dhunuar shtetin! Partia multietnike VV-ja është ende e para, pa një diferencë të madhe. PDK-ja nuk është keq, LDK-ja do të rritet më së shumti. AAK-Nisma është mbi 10 për qind, Koalicioni për Familjen, nuk e besoj se merr në thua në prag. Shpërndarje votash, si asnjëherë më parë. VV-së sot i erdhi një përkrahje e madhe, nga akademik Rexhep Qosja dhe historiani i të gjitha regjimeve, Hakif Bajrami. Akademik Rexhep Qosja po mbështet, solidarizohet politikisht dhe intelektualisht me akademikun e VV-së, Agim Bahtirin. Çfarë energjie e çfarë sinergjie! Si intelektual dhe mendimtar, Rexhep Qosja përbënë ajkën e trurit kombëtar. Mendoj se Enver Hasani dhe Rexhep Qosja janë në mesin e 10 intelektualëve shqiptarë, kudo që jetojnë shqiptarët në botë. Si politikan, Enver Hasani ka qëndrueshmëri dhe parimësi profesionale ndërsa Rexhep

Qosja fare pak merr vesh në politikë prandaj, me dashje hynë në shërbim të mediokritetit politik. Është mëkat që një dijetar si Rexhep Qosja të mbytet në batakun e mediokritetit politik aq më parë që ka dështuar në çdo përpjekje politike. Hakif Bajrami mbështillet me një sofizëm provincial, e ka ambalazhimin e Bacë Adem Demaçit kurse përmbajtjen e Albin Kurtit e që janë pozicione krejtësisht të papajtueshme. Albini i ditëve tona nuk ka asgjë të përbashkët me Bacë Adem Demaçin. Ose, thënë figurativisht, Albin Kurti është vazhdues i veprimtarisë humane, politike dhe kombëtare për aq sa unë jam vazhdues i politikës së Dobrica Qosiqit.

Për kënd duhet të bëhet gara: VV-ja, PDK-ja, LDK-ja, AAK-NISMA kanë një bërthamë të votuesve tradicionalë dhe, nëse duan të kalojnë sa më mirë duhet të përpiqen të fitojnë votat e: 1. 150.000 votuesve të rinj që votojnë për herë të parë. 2. Votuesve të "fjetur", të papërcaktuar dhe 3. Votuesve nga diaspora.

Po, për një jam i sigurt se nuk do të ketë qeveri vetëm me një parti si pas zgjedhjeve të vitit 2021. Kush me kë bënë koalicion, është pyetje për 99 cent jo për një milion dollarë. Rezultati në këto zgjedhje do të ndikojë edhe në rezultatit e zgjedhjeve lokale prandaj, VV-ja në asnjë rrethanë nuk duhet ta humbë Shtimen ku sundon "çlirimtari" e që materialisht përkrahet nga Hekuran paramilitari. Akademik Rexhep Qosja në arsyetimin klientelist pse duhet të përkrahet dhe votohet VV-ja, askund nuk e thekson suksesin e madh që e ka VV-ja në Shtime ku mbrohet bastioni i fundit i një injorance politike. Kosova po hynë në një labirint turbulent ku të gjitha rrugët, siç thuhet nuk çojnë në Romë por në veri të Kosovës. Aty Kosova ose do të bëhet shtet, ose do të ikën përlesh. Në vend të politikës përfruese dhe përbashkuese, Kurti, duke nënçmuar poshtërsisht opozitën e ka hapur Kutinë e Pandorës, pa mundësi të fusë brenda Kaçketën, Faraonin egjiptas, Lenka Çukon dhe akademik Agim Katravellën, kandidatë serioz për Listën Esenciale të Thesarit të shtetit amerikan. Drenica nuk duhet ta pengojë fushatën e Albin Kurtit, duhet ta presë bujarisht por nuk duhet të lejojë që Kompleksi i Prekazit të vizitohet nga Mimoza Zemplakica, Hekuran Paramilitari, Lenka Çukon, Kaçketë Dezertori, Hysen Frikacaku, Shemë Faqeziu, Komandant Pasuli dhe Katrane Shvarci, si parandalim i ndotjes kombëtare, politike dhe shpirtërore.

Vendimi i ministrit Vitia për çmimet e unifikuara të barnave përfundon në Gjykatën Komerciale

PRISHTINË, 28 JANAR - Vendimi i ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia, për çmimet e unifikuara të barnave, është aktualisht në shqyrtim nga Gjykata Komerciale e Kosovës. Ky vendim ka shkaktuar një sërë reagimesh të ndryshme nga farmacistët, distributorët e barnave dhe të tjerë të prekur nga ky vendim i ministrit Vitia. Kadri Bytyçi, kryetar i Odës së Farmacistëve, ka konfirmuar se janë në pritje të vendimit të Gjykatës Komerciale për të vendosur më tutje se si do të veprojnë. Gjithashtu, Bytyçi tha për "Telegrafi"-n se kanë realizuar edhe një pyetësor për vendimin e ministrit. "Pyetësori e kemi bërë, dhe kemi atakuar vendimin e ministrit si odë. Kërkesa e komunitetit tonë ka qenë se është vendim jo në përputhje me ligjin, ku neni gjashtë i obligon farmacistët me qit çmime për barna, e që është në kundërshtim me udhëzimin administrative për banderola, sepse vetëm në banderola del

çmimi. Njëkohësisht ne kemi atakuar edhe në aspektin juridik, në Gjykatën Komerciale në Departamentin për Çështje Administrative vendimin e ministrit. E kemi atakuar ku kemi kërkuar masë sigurie apo pezullim, por kryesisht ka të bëjë me pikën e gjashtë, ku i dëmton shumë kolegët tanë farmacistë", ka theksuar ai. I pyetur se a kanë pasur komunikim me Ministrinë e Shëndetësisë, Bytyçi deklaroi se MSh nuk është përgjigjur në kërkesat e tyre. "Absolutisht nuk janë përgjigj. Kemi bërë disa kërkesa, për mos me thonë shumë të tilla, ku kemi deklaruar se ne jemi pro ligjit por, megjithatë, ligji nuk duhet t'i dëmtojë kolegët tanë të cilët punojnë e veprojnë në farmacitë e tyre duke dhënë shërbime mbi dhjetëra mijëra qytetarë brenda ditës. Po, ne jemi tu e pritë vendimin e Gjykatës, njëkohësisht kemi shpreh edhe një shqetësim tonin, se vendimi i ministrisë mundet me qenë vetëm në



favor të monopoleve apo disa oligarkëve", tha ndër tjera ai. Kryetari i Odës së Farmacistëve tha që shpreson që vendimi i Gjykatës Komerciale të jetë i drejtë, duke shtuar se provat që kanë paraqitur janë pro ligjeve që janë në fuqi në Republikën tonë. Bytyçi, gjithashtu, theksoi se nëse vendimi nuk është i drejtë, atëherë "kolegët tanë njëzëri janë deklaruar se janë të gatshëm edhe të mbajnë grevë,

në qoftë se në farmaci tentohet të shkohet dhe t'u kërkohej diçka që është antiligjore". Konfirmimin e padisë e kanë konfirmuar edhe nga Gjykata Komerciale e Kosovës. "Në referim të kërkesës tuaj ju njoftoj se Gjykata Komerciale - përkatësisht Departamenti për Çështje Administrative, padinë në fjalë e ka pranuar më 21.01.2025", ka konfirmuar për "Telegrafi"-n, Albënora Bektashi Hoti nga Gjykata

Komerciale. Për këtë vendim shqetësime kishte shprehur edhe Ismail Shurdhaj, kryetar i Shoqatës së Distributorëve të Produkteve Farmaceutike dhe Medicinale të Kosovës. Shurdhaj kishte deklaruar se me vendimin e MSh-së tregu nuk do të mund të furnizohet me produkte farmaceutike, dhe se qytetarët do të detyrohen të dalin jashtë Kosovës për të blerë ato. Para një muaji ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, kishte njoftuar se kishte nënshkruar listën finale për çmimet e unifikuara të barnave. Vitia këtë e bëri të ditur përmes një postimi në rrjetin social duke shkruar se kjo i hap udhë jetësimit të Ligjit për Çmimet e Unifikuara të Barnave. "Për herë të parë barnat do të jenë me çmime të njëjta kudo dhe më të ulëta sesa tani. Në disa nga barnat, çmimet janë ulur 5 deri në 10 herë. Ulje të ndjeshme ka në mbi 2 900 produkte medicinale", kishte njoftuar ministri.

Universiteti i Prishtinës forcon lidhjet me universitetet izraelite

PRISHTINË, 28 JANAR - Ambasadorja e Izraelit në Kosovë, Tammy Ziv dhe rektori i Universitetit të Prishtinës, Arben Hajrullahu, janë pajtuar në një takim, që bashkëpunimet universitare mund t'i forcojnë urat e miqësisë mes dy popujve e shteteve. Rektori Hajrullahu i tregoi mysafires së tij të lartë, se Universiteti i Prishtinës është i interesuar të bashkëpunojë me universitete izraelite në fushat e bujqësisë, teknologjisë informative dhe menaxhimit të ujërave.



Ambasadorja Ziv tha se Izraeli është shteti numër një në botë për menaxhim ujërash, ndërsa sugjeroi për këtë qëllim dhe për

teknologji informative, bashkëpunim të UP-së me Thecnion - Institutin e Teknologjisë së Izraelit. Ambasadorja përmendi se Universiteti Hebraik në Jerusalem ka një program shumë të mirë për bujqësi. Për këtë fushë e lavdëroi edhe Institutin e Hulumtimeve Volcani. Një student nga Kosova tashmë është duke studiuar në nivelin master në Universitetin e Haifas në Izrael, ndërsa sipas ambasadores së këtij shteti, pritet t'i nisnin studimet edhe dy studentë të tjerë nga Kosova.

Bashkëpunime të personelit dhe studentëve të universiteteve izraelite dhe UP-së kanë ndodhur dhe do të ndodhin edhe në Universitetin Veror të Prishtinës që sivjet shënon përvjetorin e 25-të. Në takim me ambasadorën e Izraelit Tammy Ziv morën pjesë edhe prorektorja për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim akademik, Rozafa Basha, dekani i Fakultetit të Edukimit, Blerim Saqipi dhe drejtori i Zyrës për Kërkime dhe Projekte të Sponsorizuara, Fitim Seferi.

Opozita e bashkuar vazhdon ta lë qytetarin e Gjilanit pa buxhet

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

GJILAN, 28 JANAR - Në mbledhjen urgjente të Kuvendit Komunal të Gjilanit të thirrur nga kryetari i komunës së Gjilanit, lidhur me miratimin e buxhetit të vitit 2025, nuk kanë marrë pjesë këshilltarët e LDK-së, të PDK-së dhe të AAK-së. Të pranishëm në seancë ishin 10 këshilltarë, kurse mungonin 25. Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Gjilanit, Kushtrim Kadriu, tha se rregullorja dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale qartësojnë se duhet të jenë të pranishëm 50+1 të këshilltarëve në kuvend dhe të martën nuk ka kuorum për të vazhduar më tej dhe shpallet e mbyllur seanca, derisa doli nga salla. Ndërsa nënkryetarja e komunës së Gjilanit, Leonora

Morina-Bunjaku, tha se kjo mbledhje urgjente është thirrur dhe sot opozita nuk po merr pjesë. "E ndiejmë obligim t'i njoftojmë qytetarët, si përfaqësues të tyre e kemi për detyrë të shenjtë që të kenë shërbime dhe projekte që e meritojnë", tha Morina Bunjaku. Ajo më tej shtoi se votimi i buxhetit është një detyrim moral dhe ligjor ndaj atyre që na kanë besuar. Buxheti është shtylla kryesore për zhvillimin e projekteve që prekin jetën e qytetarëve. Nënkryetarja e Gjilanit i ftoi të gjithë këshilltarët t'i lënë dallimet politike dhe të veprojnë për të mirën e komunitetit. "Kemi bërë përpjekje dhe jemi të gatshëm që të diskutojmë çdo shqetësim apo diskutim për buxhetin. Le ta gjejmë zgjidhjen e



përbashkët", tha Morina-Bunjaku. Ajo tha se sot ndodhen në një situatë të vështirë, pasi opozita nuk është në sallë. Sipas saj, buxheti nuk është një dokument ku mund të fitojnë e humbasin politikisht, por për të mirën e përbashkët. "Mosmiratimi i buxhetit do të thotë ndalim i

projekteve në mes, shërbime të vonuara apo të ndërprera plotësisht, familje që humbasin mbështetje", tha Morina-Bunjaku. Nënkryetarja e komunës kërkoi nga opozita, nëse ka kërkesa konkrete, t'i sjellë e do të trajtohen. "Buxheti i këtij viti nuk është për pozitën e as për

opozitën, por për qytetarët që presin rrugë më të mira, nxënësit që presin kushte më të mira, për bizneset që presin mbështetje, për familjet që kanë nevojë", tha Morina-Bunjaku. Më tej ajo i ftoi anëtarët e kuvendit të votojnë për të mirën e përbashkët dhe të jepet një mesazh i qartë se punohet për qytetarët. "Buxheti ndoshta nuk është i përkryer, por është një hap i madh drejt realizimit të synimeve tona dhe çdo hap i ndërprerë sot është një humbje për qytetin e komunën tonë. Të nderuar kolegë, mendoni për qytetarët që përfaqësoni, për ata që na kanë dhënë këtë detyrë dhe besim", tha Morina-Bunjaku. Nënkryetarja kërkoi votimin e buxhetit për një të ardhme më të mirë, të sigurt e të qëndrueshme për të gjithë.

Rriten çmimet e shportës

PRISHTINË, 28 JANAR - Çmimet e prodhimeve bazë të shportës familjare kanë shënuar ngritje. Qytetarët ankohen se me rrogat që marrin, thuajse e kanë të papërballueshme t'ia dalin deri në fund të muajit.

Derisa po dilte nga dyqani, Betimi, një qytetar nga Prishtina, tha për "Radio Kosovën" se çmimet e produkteve ushqimore dhe të energjisë elektrike kanë shënuar ngritje, dhe thuajse është bërë e pamundur t'ia dalin me pagat aktuale. "Kemi ngritje të çmimeve sidomos në produkte bazë. Problemi është edhe në gjërat e tjera. Energjia elektrike është rritur, faturat po vijnë shumë të larta dhe me këto paga është bërë shumë problem t'ia dilet", tha ai.

Selatin Kaçaniku nga OJQ "Konsumatori" i tha "Radio Kosovës" se çmimet nuk po arrijnë t'i kontrollojnë as në botë e lere më në Kosovë. Sipas

tij, për këtë arsye, shtresa e mesme e shoqërisë në vend është në prag të falimentimit. "Që nga koha e pandemisë kemi rritje alarmante të çmimeve, të cilat nuk po mund të kontrollohen as nga qeveritë dhe shtetet më të forta në botë, e lere më te ne. Të gjitha produktet që ne importojmë janë më të shtrenjta në Kosovë se në vendet e Bashkimit Evropian. Pata thënë në pandemi, se nga rritja e çmimeve do të falimentojnë konsumatorët e varfër, por tani them se falimentimi po e kërcënon edhe shtresën e mesme", theksoi Kaçaniku.

Ndërkaq kryetari i Aleancës së Bizneseve të Kosovës, Agim Shahini, theksoi se ngritjen e çmimeve po e dikton importi i lartë. Shahini konsideron se këtë vit ka ulje të çmimeve në vend krahasuar me vitin e kaluar. "Ngritja dhe ulja e çmimeve varet nga importi,



sepse ne importojmë 6 miliardë euro dhe prodhuesit vendorë kanë pak ndikim në tentimin për

ta ulur çmimin në produktet e veta. Por, mund të them se çmimet këtë vit janë më të ulëta

se në vitin e kaluar. Po provojmë që prodhuesit vendorë të kenë më shumë ofertë, cilësi më të mirë, po ashtu çmime më të lira. Ky vit po karakterizohet si vit zgjedhor, kështu që ekonomia dhe prodhimi do të jenë jashtë vëmendjes", tha Shahini.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, norma mesatare vjetore e inflacionit për vitin 2024 është 1,6 %.

Indeksi i tërësishtëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte më i lartë në një mesatare prej 0,7 % në muajin dhjetor 2024 krahasuar me muajin nëntor 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të energjia elektrike (6,2 %), perimet (2,5 %), kafja, çaji (2,2 %) dhe qumështi, djathi dhe vezët (1,3 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,8-përqindësh në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit.

"Coca-Cola" urdhëron tërheqje masive të pijeve në Evropë



PRISHTINË, 28 JANAR - Njëسيا evropiane për mbushjen e pijeve të kompanisë "Coca-Cola" tha të hënën se ka urdhëruar një tërheqje masive të pijeve "Coke", "Sprite" dhe të tjera, pasi ka vërejtur nivele të larta të kloratit të cilat mund të paraqesin rreziqe shëndetësore.

"Coca-Cola" tha se kanoçet dhe shishet e qelqit që kishin nivele të larta të kësaj substance ishin shpërndarë në Belgjikë, Holandë, Britani, Gjermani, Francë dhe Luksemburg që nga nëntori i vitit të kaluar, deklaruan për AFP-në nga kompania "Coca-Cola Europacific Partners" në Belgjikë. "Nuk kemi një shifër të saktë, por është e

qartë se është një sasi e konsiderueshme", tha kompania lidhur me sasinë e pijeve me nivele të larta të substancës kimike.

Nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës i thanë Radios Evropa e Lirë se deri më tani nuk kanë pranuar ndonjë njoftim lidhur me dyshimet e sigurisë së produktit të "Coca-Cola" në tregun e Kosovës. "AUV deri më tani nuk ka ndonjë njoftim për dyshime rreth sigurisë së produktit 'Coca Cola' që tregtohet në Kosovë. Jemi duke e monitoruar situatën përmes mekanizmave të kontaktimit me autoritete dhe organizata të sigurisë së

ushqimit. Mbi çdo ndryshim, konsumatorët do t'i mbajmë të informuar", tha Lamir Thaçi nga AUV.

Për sigurinë ushqimore Kosova merr njoftime nga Sistemi për Paralajmërim të Shpejtë për Ushqim (RASFF) i Bashkimit Evropian.

Klorati mund të gjendet në ushqime, pasi buron nga dezinfektuesit me klor që përdoren gjerësisht për trajtimin e ujit dhe përpunimin e ushqimit. Në një opinion shkencor të publikuar më 2015, Autoriteti Evropian për Siguri të Ushqimit tha se ekspozimi afatgjatë ndaj kloratit përbën shqetësim të mundshëm shëndetësor për

fëmijët, veçmas tek ata që kanë mungesë të vogël apo të mesme të jodit. "Shumica e produkteve të prekura ishin produkte të pashitura që veçse janë tërhequr nga raftet e dyqaneve dhe ne vazhdojmë të ndërmarrim masa për t'i larguar produktet e mbetura në treg", tha "Coca-Cola Europacific Partners".

Por, dega franceze e kompanisë tha se analizat nga ekspertë të pavarur "erdhën në përfundim se mundësia e lidhjes me një rrezik" ishte "shumë e vogël". "Ne nuk kemi pranuar asnjë ankesë nga konsumatorët", tha kompania.

Pijet e prekura të "Coke" dhe "Fuze Tea" ishin shpërndarë në

Francë, por aktualisht urdhri për tërheqjen e produkteve nuk po aplikohet në Francë, shtoi kjo kompani.

"Coca-Cola Europacific Partners" tha se u kërkoi falje konsumatorëve për urdhrin për tërheqje. Kompania tha se nivelet e larta të substancës u vërejtën gjatë një kontrolli rutinor në fabrikën e prodhimit në Gent.

Produktet e prekura kishin kodin e prodhimit nga 328 GE deri në 338 GE, dhe përfshinin edhe brendet sikurse Minute Maid, Nalu, Royal Bliss dhe Tropicco, tha kompania, duke shtuar se është në kontakt me autoritetet kompetente në tregjet e prekura.

Drejtori i ATK-së dhe ambasadori i Luksemburgut diskutojnë për bizneset

PRISHTINË, 28 JANAR - Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka pritur në takim ambasadorin e Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz, me të cilin

kanë diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit dhe të mbështetjes për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit tatimor.

Bashkëpunimi me Ambasadën e Luksemburgut pritet t'i sjellë përfitime të ndryshme institucionit të ATK-së dhe bizneseve.

Drejtori Murtezaj ka falënderuar ambasadorin për gatishmërinë për të qenë partner në rrugën drejt një administrate moderne dhe efikase.



Pse Erdogan mund të bëjë paqe me PKK-në



Në Turqi, një thashethem po përhapet dhe po merr vull: Abdullah Öcalan, një nga themeluesit e Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), i klasifikuar si terrorist nga Ankaraja, do të lirohet më 15 shkurt nëse arrin të bindë grupin kurd, e cila ka luftuar për dekada për autonomi të Kurdistanit, për të hedhur armët.

Data nuk zgjidhet rastësisht. Korrespondon me arrestimin, më 15 shkurt 1999 në Kenia, ku lideri u burgos dhe u dënua me burgim të përjetshëm. Njëzet e gjashtë vjet më vonë, dhe ndërsa lufta guerile midis shtetit turk dhe PKK-së ka shkaktuar vdekjen e më shumë se 40 mijë njerëzve, një gjest i papritur nga lideri i ekstremit të djathtë turk, Devlet Bahçeli, një shtyllë e koalicionit qeverisës filloi një proces pajtimi tetorin e kaluar.

Njeriu që dikur sugjeroi që dënimi me vdekje të zbatohet për "Apo"-n, do të varroste kapelën, i mbështetur nga një president turk që dëshiron t'i japë fund "fazullit të terrorizmit".

Për disa javë, ultranacionalisti ka udhëhequr negociatat me Abdullah Öcalan, nëpërmjet anëtarëve të Partisë për Barazi Popullore dhe Demokraci (DEM), partia pro-kurde e vendit. Nga qelia e tij, ai thotë se është "i vendosur" të marrë pjesë në proces, por preferon të shfaqë "optimizëm të kujdesshëm". Në të kaluarën, përpjekje të ngjashme për të rinovuar dialogun për një paqe të qëndrueshme me kurdët kanë dështuar.

Një paqe e pamundur

"PKK mund të jetë në favor të çarmatosjes ose heqjes dorë nga lufta kundër Turqisë. Megjithatë, është e sigurt që grupi nuk do të dorëzojë armët nëse nuk fiton asgjë në këmbim", siguron Mesut Yegen, një sociolog i specializuar në çështjen kurde.

Në diskutim: amnisti për luftëtarët kurdë, dhënia e të drejtave civile dhe kulturore, veçanërisht të të drejtave gjuhësore për pakicën turke dhe lirimi i disa figurave kryesore të kauzës. "Paqe pa demokraci" më duket e pamundur, por jo e pamundur," komenton Yasar Aydin, një studiues në Qendrën për Studime të Aplikuara të Turqisë (CATS) të Institutit Gjerman për Çështjet Ndërkombëtare dhe të Sigurisë (SWP).

Për ta bërë këtë, Ankaraja duhet të përqendrohet në juglindjen e vendit, e cila është kryesisht kurde, ku duhet të forcojë aftësitë e komuniteteve lokale dhe të zbatojë projekte zhvillimi, thotë specialisti.

"Turqia duhet gjithashtu të heqë veton e saj për autonominë e pjesshme (të një administrate kurde) në Siri," vazhdon ai. A është Ankaraja gati të japë këto lëshime? Autoritetet, të cilat po përpiqen të shtypin çdo dëshirë për pavarësi në kufijtë e saj, kanë bërë kohët e fundit thirrje për shpërbërjen e Njësisë të Mbrojtjes së Popullit (YPG), të cilat ata e konsiderojnë si shtrirje siriane e PKK-së, nën dënimin për të udhëhequr një

ofensivë në veri të Sirisë.

Në Damask, grupi Hay'at Tahrir al-Sham (HTC) ka vënë tashmë një frenim mbi kërkesat kurde për autonomi, duke detyruar Forcat Demokratike Siriane (SDF) të mbështetura nga Washingtoni të shpërbëhen dhe t'i bashkohen ushtrisë, për momentin duke pasur sukses. Nga pala turke, iniciativa shihet shumë mirë, por mund të mbjellë përçarje brenda organizatës PKK.

Disa figura në mesin e liderëve lokalë, të vendosur në malet Kandil të Irakut, si dhe në Siri, kishin shprehur tashmë mospajtimin e tyre me direktivat e Abdullah Öcalan për procesin e paqes. Sipas Mesut Yegen, një kompromis është i mundur nëse diskutimi mbetet i hapur midis dy fqinjëve të mëdhenj, me mbështetjen e Washingtonit: "Nëse shteti turk dhe regjimi i ri në Siri bien dakord t'u japin një autonomi të caktuar kurdeve siriane dhe që YPG lejohet të operojë brenda ushtrisë siriane në rajonet kurde të Sirisë, PKK mund ta konsiderojë këtë suksesin e vet. Dhe për këtë arsye do të ishte më e favorshme për çarmatimin e organizatës së saj".

Duke anashkaluar Izraelin

Ndërsa zhvillimet në Siri hapin një dritare mundësie për Turqinë për të zgjidhur çështjen kurde, sukseset ushtarake dhe planet e Izraelit për të riformuar rajonin gjithashtu i bëjnë presion Ankaranë për të zbutur një kërcënim tjetër të mundshëm.

Që nga rënia e Bashar al-Assad,

shteti hebre në fakt ka shumëfishuar thirrjet e tij ndaj komunitetit kurd, duke nënvizuar mundësinë e krijimit të një aleance strategjike me grupet e tij lokale. Ndërsa mbështetja e Izraelit për kauzën kurde nuk është e re, ajo tani mund të shërbejë për të përmbajtur pikëpamjet ekspansioniste të Turqisë në fqinjin e saj sirian, për të balancuar forcat islamike në rajon dhe për të ndëshkuar përplasje verbale të Ankarasë kundër Izraelit gjatë luftës së Gazës.

Sipas Haaretz, Izraeli madje po shqyrton përfshirjen e kurdeve në Marrëveshjen e Abrahamit. Një ide e diskutuar me dyer të mbyllura e cila mund të ofendojë rëndë presidentin turk. Përballë ardhjes në pushtet të Izraelit, "Ankaraja është e vendosur të forcojë pozicionin e saj në skenën politike ndërkombëtare", thotë Yasar Aydin. "Kjo do të arrihet duke lehtësuar konfliktin kurd, duke qetësuar deri diku PKK dhe duke forcur kohezionin social brenda vendit".

Mundësi zgjedhore

Sepse një objektiv tjetër ka të bëjë me reis-in: mbajtja e tij në pushtet, ndërkohë që ai kërkon aktualisht mandatin e tretë dhe të fundit të autorizuar nga Kushtetuta. Një kufi që kreu i shtetit do të dëshironte ta kapërcejë përmes reformës kushtetuese, për të cilën ai ka nevojë për mbështetjen në veçanti të partisë pro-kurde. "Megjithëse deputetët e DEM-it nuk do të mbështesin një


ndryshim të tillë kushtetues pa kompensim të madh për kurdët, një zgjedhje e shpejtë ka më shumë gjasa nëse procesi aktual është i suksesshëm," tha Mesut Yegen.

Për më tepër, nëse procesi është i suksesshëm, Recep Tayyip Erdogan mund të shpresojë të mbledhë votën kurde, ndërsa pakica, e cila numëron midis 15 dhe 20 milionë njerëz, është larguar kryesisht nga partia në pushtet për shkak të politikave të saj represive.

Por a është vërtet presidenti turk i vendosur për ta bërë procesin realitet?

"Erdogan nuk duket aq entuziast sa partneri i tij Bahçeli në këtë drejtim", sugjeron sociologu. Nëse aleati i tij ultranacionalist beson se ndryshimi i kontekstit rajonal e bën procesin e paqes me PKK-në urgjente, "Erdogan mund të besojë se shteti turk mund të përballet me kushtet e reja rajonale edhe nëse paqja me kurdët nuk arrihet.

"Për më tepër, presidenti turk rrezikon shumë nëse procesi dështon: "Partitë nacionaliste mund ta përdorin kundër tij, duke argumentuar se ai ka negociuar me terroristët (sic) dhe se ka dështuar", vijon eksperti. Arrestimi të martën e kaluar në Turqi i liderit nationalist Ümit Özdag për "fyerje të presidentit" mund të shihet si një nga masat e para paraqra të reis.



Ramadani: Bëjmë të pamundurën në kualifikueset e Botërorit

Në mbrëmjen "Gala" të futbollit shqiptar, mesfushori i kombëtares, Ylber Ramadani, mori çmimin "zemër kuqezi". I përzgjedhur nga stafi teknik i Kombëtares kuqezi për

kontributin e dhënë në fushë, Ramadani nuk hezitoi të fliste për mediet. Ai shprehet se është krenar, ndërsa sa iu takon kualifikueseve të Botërorit, futbollisti premtonte se skuadra

do ta japë maksimumin. "Ndiem shumë krenar. Doja ta falënderoja edhe trajnerin sepse edhe ai ka votuar që unë ta marr këtë çmim. Jam jashtëzakonisht krenar sepse dua ta përfaqësoj

vendin dhe të arrijmë rezultate sa më të mira. Kualifikueset e Botërorit - Grupi nuk është i lehtë, por ne do të futemi ta bëjmë maksimumin në çdo ndeshje. Kjo nuk diskutohet. Pa

marrë parasysh se kë kemi kundërshtar. Mendoj se futbollit ka surpriza dhe ne duhet ta bëjmë maksimumin për të bërë diçka të tillë", ka thënë Ramadani.

Trepça dhe Prishtina në kërkim të finales së Kupës



MITROVICË, 28 JANAR - Mesjava sjell superndeshjet e kthimit në gjysmëfinalet e Kupës së Kosovës të meshkujt. Ndeshje mjaft interesante pritet ndërmjet Trepçës dhe Sigal Prishtinës, si dhe në mes të Bashkimit dhe Vëllaznimit, ku të katër skuadrat duan kualifikimin në finalen e Kupës më 12 shkurt në Prishtinë. Dy rivalet e vjetra, Trepça dhe Sigal Prishtina, përballen të mërkurën në "Minatori", ku pritet atmosferë e zjarrtë. Në ndeshjen e

parë prishtinasit fituan 67:65, edhe pse kishin epërsi deri në 24 pikë, 27:3. Dy pikë dallim bën që sfida të jetë e paparashikueshme. Mitrovicasit duhet të fitojnë me tri pikë dallim nëse duan kualifikimin tutje, ndërsa bardhekaltrit humbja me një pikë, barazimi apo fitorja i kualifikon tutje. Përballje tjetër e 'zjarrtë' pritet edhe në Prizren, ku përballen Bashkimi dhe Vëllaznimi, ku dy skuadrat synojnë kualifikimin në finale. Takimi i parë në Gjakovë

përfundoi me fitoren e kuqezinjve 80:71. Prizrenasit synojnë fitoren me dhjetë pikë dallim, ndërsa skuadra nga Gjakova mund të kualifikohet edhe me tetë pikë dallim.

GJYSMËFINALET E KTHIMIT

Të mërkurën takohen:
18:30 Trepça - Sigal Prishtina

Të enjten takohen:
18:30 Bashkimi - Vëllaznimi

SHKURT

Federata e Boksit organizon turneun 'Pavarësia'

Federata e Boksit e Kosovës për të 17 herë do ta organizojë turneun ndërkombëtar tradicional "Pavarësia 2025". "Në këtë turne do të marrin pjesë shtetet e rajonit Bullgari, Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova", thuhet në njoftimin e FBoxK-së. Sipas këtij njoftimi, turneu mbahet më 15 shkurt nga ora 13:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.

Berisha rikthehet tek Augsburgu

Sulmuesi Mërgim Berisha është rikthyer sërish tek Augsburgu. Berisha kishte qenë një vit e gjysmë te Hoffenheimi në formë huazimi. Nuk dihen hollësitë e kësaj marrëveshjeje, mirëpo Berisha është shprehur tejet i lumtur. "Vërtet doja që të kthehesha tek Augsburgu, sepse këtu përjetova kohën më të mirë në karrierë. Jam ndier në shtëpi këtu, kam shënuar shumë gola dhe jam përmirësuar shumë si lojtar", ka thënë Berisha.

Korenica në formacionin e javës në Rumani

Meriton Korenica ka vazhduar shkëlqimin në elitën e futbollit rumun me fanellën e CFR Cluj. Mesfushori nga Kosova ka qenë fantastik në ndeshjen që Cluj e ka fituar 3-1 ndaj Farul Constancas. Korenica ishte fantastik në këtë takim duke qëndruar në fushë për gjatë 80 minutave. Ylli nga Rahoveci ka asistuar në golin e tretë. E falë paraqitjes fantastike në këtë sfidë, Korenica ka zënë vend në formacionin e javës së xhiros së 23-të në Superligën e Rumanisë.

Kosova U19 dhe U17 mësojnë kundërshtarët e Evropianit

PRISHTINË, 28 JANAR - Të martën në Vjenë është tërhequr shorti edhe për Kampionatet Evropiane të grupmoshës U19 (vajzat). Kosova U19 garon në Evropianin B që mbahet në Gjeorgji prej 12 deri më 20 korrik. Shorti ka përcaktuar që vajzat tona të garojnë në Grupin B, së bashku me Italinë, Izraelin, Britaninë e Madhe dhe Belgjikën. Në Grupin A janë Sllovakia,

Gjeorgjia, Luksemburgu, Bullgaria dhe Ukraina. Kosova U19 do ta kërkojë suksesin në Gjeorgji. Bëhet fjalë për gjeneratën që vjet u paraqit në Kampionatin Botëror. Në Vjenë është tërhequr shorti për Kampionatin Evropian për hendbollistet deri 17 vjet që gjatë muajit gusht mbahet në Prishtinë. Në Evropianin B në Prishtinë paraqiten tetë ekipe kombëtare. Kosova U17

do të jetë në Grupin A së bashku me Finlandën, Letoninë dhe Bullgarinë. Ndërkohë në Grupin B do të garojnë Italia, Izraeli, Ukraina dhe Britania e Madhe. Ndeshjet në "W17 EHF Championship 2025" do të zhvillohen prej 4 deri më 10 gusht në kryeqendrën tonë. Vajzat e Kosovës e kërkojnë suksesin në këtë kampionat kontinental.



Përmbillet procesi i zgjedhjeve në shtatë Lidhjet/Rajonet e Futbollit

PRISHTINË, 28 JANAR - Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka shprehur falënderime të sinqerta për të gjitha regjionet për organizimin dhe procesin e zgjedhjeve për kryetarët e regjioneve. Ai i ka përgëzuar anëtarët e regjioneve për vlerësimin dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm për zhvillimin e futbollit në

rajonet e tyre. "Vitet e fundit puna juaj ka qenë e jashtëzakonshme! Ju keni kontribuar në avancimin e futbollit, organizimin e garave në mënyrën më të mirë të mundshme dhe masivizimin e këtij sporti. Shumë shkolla futbollit janë hapur të reja, ndërsa ato ekzistuese kanë shtuar ndjeshëm numrin e

anëtarëve. FFK do të vazhdojë të qëndrojë pranë jush, duke ju mbështetur me projekte konkrete për regjionet. Reforma të reja dhe me shumë përgjegjësi do të pasojnë në organizimin e garave, punët administrative dhe zbatimin e vendimeve të dala nga KE e FFK-së. Me theks të veçantë, do të

angazhohemi për digjitalizimin e LRF-ve përmes platformës 'My FFK'. Ju uroj punë të mbarë dhe shumë suksese në detyrat tuaja! Vazhdojmë me krenari e përgjegjësi", ka shkruar Ademi. Kryetarët e zgjedhur në regjionet e FFK-së: Ismajl Ajeti (Prishtina), Bardhec Seferi (Mitrovicë), Avdi



Gashi (Pejë), Mirsad Qollaku (Prizren), Ilaz Mjaku (Ferizaj), Armend Misini (Gjilan), Agim Nura (Gjakovë).

Low: Si e binda Musialan të luante për Gjermaninë

BERLIN, 28 JANAR - Joachim Low, ish-trajner i Gjermanisë, ka dhënë një intervistë të gjatë për "Kicker", ku ka folur edhe për Mesut Ozilin dhe rëndësinë që ai pati gjatë kohës kur ai ishte në krye të Kombëtares: "Gjatë periudhës sime si trajner ishte një dhuratë e pabesueshme për ne. E dënoj disi atë që ndodhi pas vitit 2018, sepse ai e la Kombëtaren, që ishte familja e tij për vite me radhë, pa e përshëndetur. U ofendua dhe shpërtheu një stuhit kundër tij dhe Ilkay. Nga ana tjetër, do të kisha dashur që të gjithë ne të kishim një largim të ndryshëm. E kam kritikuar, por një vit më vonë folëm. Megjithatë, është turp. Mesut është kampion bote, ai i përket një gjenerate të artë dhe ka qenë lojtar i jashtëzakonshëm gjatë viteve pas 2006". "Pas Botërorit të vitit 2018, të bëja një hap prapa do të kishite qenë gjëja e duhur. Eliminimi në fazën e grupeve në Rusi ishte një goditje e fortë, por unë doja ta shkujta këtë turp



bashkë me Oliver Bierhoff. Kishim një valë inati që donim ta kthenim në energji pozitive. Dy ose tre vjet më vonë e kuptova që do të ishte momenti i duhur për të ikur. Një përvojë kaq negative nuk ishte e mirë. Do të kisha dashur ta hapja rrugën për dikë tjetër që të vinte me ide të reja dhe të 'priste' gjeneratën e artë", ka shtuar Low. Ish-trajneri i kombëtares gjermane foli edhe për mënyrën se si arriti ta bindte Musialan të luante për Gjermaninë. "U takuam në Mynih. Kishim biseduar disa herë më parë dhe para Evropianit të 2021-s. Oliver

Bierhoff dhe unë e vizituam. Për herë të parë në karrierën time si trajner, i premtova një lojtar në fillim që do të ishte pjesë e skuadrës për Evropianin. Musiala ishte një lojtar rezervë te Bayerni në atë kohë, por ne kishim parë tashmë talentin e tij. E dinim që mund të ishte shumë i rëndësishëm për Kombëtaren tonë. Kështu që duhej ta lidhim atë. Musiala ishte pak i pasigurt, sepse kishte dhe miq në Angli, si Bellingham. I premtuam se do të ishte aty në turne. Por, gjithashtu, i thamë se do të duhej të zgjidhte me zemër", ka deklaruar Low.

Lakersat korrin suksesin e katërt radhazi, Clevelandi mbron kreun në Konferencën e Perëndimit

CHARLOTTE, 28 JANAR - Clevelandi mbetet në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 110-91 ndaj Detroitit. Të gjithë titullarët e Cavaliersit realizuan mbi 10 pikë, duke bërë dallimin në fushë. Fitorja e katërt radhazi për lakersat, që fituan me rezultat 112-107 në fushën e Charlottes. Mbrëmje magjike për Anthony Davisin, që realizoi 42 pikë e 23 rebounde, mbështetur edhe nga LeBron Jamesi me 22 pikë. Pas kohës shtesë fitoi ekipi i Miami, që mundi me rezultat 125-119 Orlandon. Tyler Herro me 30 pikë u dallua për vendasit. Fitore në sekondat e fundit për



Phoenixin, që falë 50 pikëve të dyshes Booker-Durant, mundi me rezultat 111-109 clippersat. Zhgënjjen Bostoni, që në fushën e tij u mund me shifrat 114-11 nga Houstoni. Brooksi me 36

REZULTATET	
Charlotte - Lakers	107-112
Cleveland - Detroit	110-91
Boston - Houston	112-114
Brooklyn - Sacramento	96-110
Miami - Orlando	125-119
New York - Memphis	143-106
Toronto - New Orleans	113-104
Chicago - Denver	129-121
Minnesota - Atlanta	100-92
Dallas - Washington	130-108
Utah Jazz - Milwaukee	110-125
Phoenix - Clippers	111-109

pikë e Thompson me 22 u dalluan për miqtë. Skuadra e Chicagos triumfoi me shifrat 129-121 ndaj Denverit, sfidë ku kolektiviteti i Bullsit bëri dallimin (7 lojtarë shënuan mbi 10 pikë).

Joao Felix, bisedime me Aston Villan

Skuadra e Aston Villas ka nisur bisedimet me Chelsea për ta siguruar sulmuesin portugez Joao Felix. 25-vjeçari nuk është titullar te

"blutë" e Londrës dhe është aktivizuar nga trajneri Maresca kryesisht në ndeshjet e Kupës në Angli apo në Ligën e Konferencës. Me

vetëm 12 paraqitje e 1 gol në Premierë Ligë këtë sezon, lojtari po kërkon një sistemim të ri dhe menaxheri i tij Jorge Mendes është duke biseduar

me drejtuesit e Aston Villas. Lojtari ka një kontratë deri në vitin 2030 me Chelsea dhe ka një kosto prej 30 milionë eurosh, por palët po punojnë

për një huazim për 6 muaj, pa të drejtë blerje. Ditët e mbetura të merkatos pritet të sjellin të reja në lidhje me këtë transferim.

SHKURT

Manaj në formacionin e javës në Turqi

Sulmuesi i Kombëtares shqiptare, Rei Manaj, është bërë pjesë e formacionit të javës së 21-të në Superligën turke. Ai udhëheq sulmin, po ashtu është vlerësuar me notën më të lartë nga të gjithë futbollistët. Manaj shkëlqeu në fundjavë duke realizuar dy gola dhe dhuruar dy asistime kundër Kaisersporit. Aktualisht skuadra e tij Sivasspor ndodhet në vendin e 13 në tabelë.

Leclerc: Duam ta kthejmë Ferrarin aty ku i takon

Ditët e fundit Lewis Hamiltoni ka tërhequr vëmendjen te Ferrari, makinë me të cilën do të garojë këtë sezon në Formula 1. Piloti britanik do të ketë si shok skuadre Charles Leclerc, që nuk synon të hapë kollaj krahu. Monegasku shpreson shumë që këtë vit të duelojë për titullin. "Formula 1 është një sport relativ dhe ne mund të dimë vetëm se çfarë bëjmë vetë. Për momentin ne po bëjmë gjithçka mirë dhe si ekip jemi shumë më solid", ka thënë Leclerc. "Ne nuk e dimë nëse Red Bull apo McLaren kanë gjetur diçka të veçantë për makinën e këtij viti. Ne fokusohemi vetëm te vetja dhe përpqimi ta bëjmë punën më të mirë që mundemi për të pasur një makinë të mirë", ka shtuar monegasku. "Ferrari është i jashtëzakonshëm, sepse ka shumë pasion brenda ekipit dhe kjo është fantastike sepse të gjithë janë të gatshëm të punojnë një orë shtesë dhe janë vërtet të motivuar për t'i ndryshuar gjërat për mirë. Kur gjërat shkojnë keq, njerëzit që punojnë këtu vuajnë më shumë, sepse ata kanë një lidhje emocionale me markën. Tani mendoj se kemi marrë këtë hap për të rikthyer këtë markë në lavdinë e dikurshme", ka deklaruar Leclerc.

Lyoni shkarkon trajnerin

Lyoni e ka shkarkuar trajnerin Pierre Sage, pas një serie pa fitore prej pesë ndeshjesh në të gjitha garat. Lyoni është i gjashti në ligën e parë franceze pasi ka arritur vetëm një fitore në pesë ndeshjet e fundit të ligës. Ai u eliminua gjithashtu nga Kupa e Francës pas një disfate nga klubi francez i nivelit të pestë Bourgoin-Jallieu në raundin e 32-të. Megjithatë, duket se do ta sigurojë kualifikimin automatik për në 1/16 e Ligës së Evropës. Francezi Sage u punësua në mënyrë të përkohshme në nëntor 2023 përpara se të shpërblehej me një kontratë të re deri në qershor 2026 pasi ai udhëhoqi klubin drejt kualifikimit në Evropa Ligë sezonin e kaluar. "Olympique Lyonnais është detyruar të pezullojë trajnerin Pierre Sage dhe anëtarët e stafit Jamal Alioui, Rui Lemos, Denis Valor dhe Remy Vercoutre, në pritje të një vendimi në ditët e ardhshme", thuhet në deklaratën e klubit francez. Sipas "L'Equipe", pronari John Textor ka qenë duke negociuar me Paulo Fonseca për dhjetë ditët e fundit. Lioni do të presë të enjten skuadrën bullgare Ludogorets në Ligën e Evropës.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Doro-Fix” Sh.p.k Stankoc, Gllgoc në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për rritjen e kapacitetit të prodhimit në fabrikën e fasadës, ngjyrave dhe llaçrave në Sankoc, Drenas.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.03.2025 në ora 10:00 në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët “Luigj Gurakuqi” fshati Sankoc, komuna e Gllgocit do të organizohet debat publik nga Kompania “Doro-Fix” Sh.p.k Stankoc, Gllgoc në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>


Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Doro-Fix” Sh.p.k Stankoc, Gllgoc për rritjen e kapacitetit të prodhimit në fabrikën e fasadës, ngjyrave dhe llaçrave në Sankoc, Drenas.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fjolla Zeka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të I të Gjimnazit “Asllan Berisha” Rogovë.
- Fjolla Zeka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të II dhe III të Gjimnazit “Xhelal Hajda-Toni”.
- Kleon Zariqit shpall të pavlefshme dëftesën e notave nga kl. I -V të, të shkollës “Ismail Qemali” Prishtinë.
- Neshet Kerleshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha”.
- Magbule Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme ekonomike “Kadri Kusari”.
- Florije Thaqi nga Rahoveci shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Gani Cavderbasha”.
- Atdhe Mustafa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme “Kadri Kusari” .
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar,
- Lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

